ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**205-25-4397-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja verore dhe dimërore e Rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për 3 vitet në vazhdim".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Tali SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shillovë, pn
(Adresa)

Gjilan ***60000***
(Vendi) ***(Kodi postar)***

+383 44 500645
Numri Telefonit) ***(Numri i Faks-it)***

Florim Zuka
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Talishpk17@gmail.com
(Adresa elektronike)

09.07.2025
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Shoqëri me përgjegjësi e kufizuara

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 26.05.2025 Data e planifikuar e hapjes së ofertave: 10.07.2025 Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim 27.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 17 i RRPP Nr.001/2022
Neni 25 i RRPP Nr.001/2022
Neni 28 i RRPP Nr.001/2022.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me dt. 26.05.2025, ndërsa ne kemi analizuar kriteret e dosjes së tenderit, mirëpo konsiderojmë se ka kritere diskriminuese përkatësisht favorizuese e të cilat duhet të ndryshohen me qëllim të hapjes së konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik.

- Tek kapaciteti teknik dhe profesional përkatësisht tek neni 9.12&9.2 i FDT-së janë specifikuar disa kërkesa diskriminuese dhe të panevojshme dhe të njëjtat do ti sqarojmë si në vijim:

Është kërkuar *"4. Vlera e terësishme e kontratave të realizuara, të përfunduara në lëminë e Mirëmbajtjes së rrugëve Nacionale, Rajonale apo Autoudhëve ose Rehabilitimit, Rindertimit dhe Zgjerimit të rrugëve, Nacionale, Rajonale dhe Autoudhëve për periudhën e shkuar tre vjeçare nga data e njoftimit per kontrate jo më pak se per:*

Lot 1 Ferizaj 13,600,000.00 €
Lot 2 Ferizaj 23,345,000.00 €
Lot 3 Gjakova 1 3,510,000.00 €
Lot 4 Gjakova 2 3,045,000.00 €
Lot 5 Gjilan 1 3,570,000.00 €
Lot 6 Gjilan 2 3,240,000.00 €
Lot 7 Mitrovica 1 4,320,000.00 €
Lot 8 Mitrovica 2 3,765,000.00 €
Lot 9 Peje 1 3,420,000.00 €
Lot 10 Peje 2 3,075,000.00 €
Lot 11 Prishtina 1 4,500,000.00 €
Lot 12 Prishtina 2 3,705,000.00 €
Lot 13 Prishtina 3 3,555,000.00 €
Lot 14 Prizren 1 3,435,000.00 €
Lot 15 Prizren 2 3,165,000.00 €

4.1 Nga vlera e teresishme e kontratave te perfunduara per periudhen e shkuar tre vjeçare OE duhet te ofrojn dëshmi se kane përfunduar projekte ne vlere 1,000.000.00 euro ne lemine e Mirembajtjes se Autoudheve (Autostradave), Rrugeve Nacionale dhe Regjionale. Kontratat e kërkuara në pikën 4.1 janë te pranueshme ne rast se kontrata është ne vijim dhe është realizuar së paku ne 65% te vlerës se saj qe do ta përmbush kërkesat nga pikat 4.1". Si dëshmi dokumentare për kërkesën e lartcekur është kërkuar *"Deshmia 4. Kopje te kontratave dhe Procesverbalet e pranimit përfundimtar (Nese aplikohet), Referenca të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve ne Mirëmbajtje të rrugëve Nacionale, Rajonale apo Autoudhëve ose Rehabilitimit, Rindertimit dhe Zgjerimit të rrugëve, Nacionale, Rajonale dhe Autoudhëve, per periudhën e shkuar tre vjeçare.*

Vërejtje: Nëse një OE ka punuar me një kompani private, pranimit përfundimtar të punëve duhet të ju bashkangjitet fatura e pagesave (transaksionet bankare), në të kundërten nuk do të pranohen si pranime përfundimtare.

Vërejtje: Referenca do te pranohet ne rastet kur OE ka qene ne cilësinë e kontraktuesit te vetëm, liderit apo anëtarit te konzorciumit.

Dëshmia 4 dhe 4.1 Lista e Projekteve të përfunduara ne lëmin e Mirëmbajtjes së Rrugëve Nacionale, Rajonale, Autoudhëve (Autostradave) per periudhën e shkuar tre vjeçare, duke specifikuar autoritetin kontraktues, vlerën e kontratave dhe datën e pranimit Teknik përfundimtar. Kopje te kontratave, Procesverbalet e pranimeve përfundimtare (nese aplikohet) ose Referencat e punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve".

Autoriteti kontraktues edhe në këtë rast ka përcaktuar kërkesa diskriminuese të cilat ju pamundësojnë ofertimin kompanive të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit. Sa për sqarim, kontratat e mirëmbajtjes verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe rajonale janë të rralla dhe jo të përsëritura çdo vit për secilin rajon apo Komunë.
Prandaj kufizimi në vetëm 3 vite e bën praktikisht të pamundur ofertimin për shumë OE të cilët kanë përfunduar projekte të ngjashme/njëjta, por jo në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë.

Kështu siç është specifikuar kërkesa e lartcekur, favorizohen direkt vetëm kompanitë të cilat kanë përfunduar projekte të natyrës së kërkuar **në tri vitet e fundit**, ndërsa praktikisht nga kjo kërkesë po determinohet fituesi qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pasi që vetëm kompanitë të

cilat kanë nënshkruar kontratat para tri viteve, mund të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj me qëllim të zgjerimit të konkurrencës dhe me qëllim që të ju mundësohet ofertimi edhe kompanive tjera me shumë përvojë në këtë fushë, kërkojmë që të zgjerohet periudha e kontratave të përfunduara nga 3 vite në 5 vitet e fundit. Një ndryshim i tillë do të hapte konkurrencën dhe do të ju mundësonte trajtim të barabartë të gjitha kompanive të interesuara për ofertim dhe me përvojë në fushën e këtij aktiviteti të prokurimit.
Edhe neni 69 i LPP-së nuk përcakton detyrimisht që duhet të kërkohen tri vitet e fundit por e lejon mundësinë, pra shkruan se mund të kërkohen, prandaj edhe nga kjo dispozitë kuptohet që nuk 2e1`q`890kufizohet kërkesa në tri vitet e fundit por varësisht prej natyrës së aktivitetit mund të kërkohen edhe për më shumë vite përvoja e punës pasi që kontratat për mirëmbajtje zakonisht në Kosovë po shpallen për periudhën trevjeçare dhe në momentin që një kompani nuk nënshkruan një kontratë tri vitet e fundit atëherë mbetet jashtë garës për të fituar ndonjë tender tjetër ndërsa në anën tjetër ka kompani që merret që një kohë të gjatë me mirëmbajtje por për shkaqe të ndryshme nuk ka arrit të nënshkruaj një kontratë në periudhën e fundit trevjeçare.

- Gjithashtu edhe kërkesa që OE të prezantojnë kontrata së pakur në vlerën në lëminë e mirëmbajtjes 1,000.000.00 euro, është kërkesë diskriminuese dhe e panevojshme përderisa në kërkesën për kontrata të përfunduara është specifikuar lëmia dhe vlera e kërkuar për secilin nga lotet. Kur kemi parasysh këtë fakt kërkojmë që të largohet në tërësi kërkesa 4.1, për kontratat e përfunduara në lëminë e mirëmbajtjes, me qëllim të hapjes së konkurrencës dhe mundësimit për ofertim të gjitha kompanive të interesuara për këtë aktivitet të prokurimit.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.30.06.2025.

PËRGJIGJE NDAJ PRETENDIMIT NR. 1

Pas shqyrtimi te pretendimeve ankimore ju sqarojmë së Autoriteti Kontraktues i refuzon si te pa bazuar dhe te pa argumentuara te gjitha pretendime ankimore nga ana e juaj. Ndërsa ju sqaron se bazuar ne te gjitha kërkesat për sqarime dhe kërkesave për rishqyrtim deri me tani aty ku ka qene e nevojshme e kemi bere korrigjimin e procedurave konform dispozitave ligjore te LPP-së.

Njëherit ju njoftojmë aktiviteti i njëjtën bazuar ne ankesën e pranuar e njëjta është ne Apel dhe AK do te pret deri ne marrjen e Vendimit nga OSHP-ja.

Andaj, kërkesa e juaj për rishqyrtim refuzohet.

Andaj, konsiderojmë se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës– Divizioni i Prokurimit, ka plotësuar të gjitha kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, konform Rregullave dhe Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, mbi përcaktimin e kritereve në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.
Nga se u tha me larte u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga kjo përgjigje vërehet qarët se nuk janë shqyrtuar fare pretendimet tona ankimore dhe me këtë rast nuk është arsyetuar fare vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim. Me këtë rast AK-së ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së paragrafi 9 ku shkruan:

9.Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e lartcekura kuptohet qartë se dosja e tenderit nuk është përgatitur në harmoni me legjislacionin në fuqi, pasi që janë vendosur kërkesa diskriminuese të cilat ju pamundësojnë ofertimin kompanive të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe

njëkohësisht favorizojnë kompani të caktuara.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*".
Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.
Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë;* ***(i)*** *pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit".*
Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se dosja e tenderit nuk është përpiluar në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është marr parasysh as neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që *"Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve".*

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se *"Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike".*

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "***Tali SH.P.K.***",

NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*